



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 83712019
Nr.i fq/Br.str./Nr.pg.
Data/Datum/Date: 16/05/19



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS PËR VIZITËN NË QENDRËN KORREKTUESE NË SMREKONICË

Për: Z. Abelard Tahiri, Ministër
Ministria e Drejtësisë

Z. Uran Ismaili, Ministër
Ministria e Shëndetësisë

Z. Nehat Thaqi, Drejtor i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Milazim Gjocaj, Drejtor
Departamenti i Shëndetësisë në Burgje

Z. Xhevdet Maqastena, Drejtor
Qendra Korrektuese në Smrekonicë

Prishtinë, 16 maj 2019

HYRJE

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 6 shkurt 2019, e ka vizituar Qendrën Korrektuese në Smrekonicë.

MKPT-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKPT-ja, më 6 shkurt 2019, vizitoi Qendrën Korrektuese në Smrekonicë (në tekstin e mëtejmë *QKS*). *QKS*-ja është institucion korrektues i tipit të hapur ku dërgohen të dënuarit me dënlime deri në dy vjet burgim dhe i nënshtrohen regjimit të hapur. Kapaciteti zyrtar i *QKS*-së është për 200 persona, ndërsa në kohën e vizitës ishin të akomoduar 135 të dënuar.

Qëllimi i vizitës

Qëllimi i kësaj vizite qe vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të dënuarve, i shërbimeve shëndetësore të cilat ofrohen për të dënuarit, si dhe i kushteve të akomodimit në pajtim me standarde vendore dhe ato ndërkombëtare për mbrojtjen e personave të privuar nga liria.

Përbërja e grupit monitorues

1. Grupi monitorues përbëhet prej dy këshilltarëve ligjorë për parandalim të torturës, një psikologe-këshilltare, një mjekë-këshilltare dhe një këshilltare-punëtore sociale.

Bashkëpunimi i *QKS*-së me MKPT-në gjatë vizitës

2. Gjatë vizitës nga MKPT-ja të Qendrës Korrektuese në Smrekonicë, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje të papenguar në të gjitha vendet e vizituara. Ekipi iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan bisedat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa prezencë të zyrtarëve korrektues dhe pa prezencë të personelit shëndetësor.

Keqtrajtimi

3. MKPT-ja, gjatë vizitës në *QKS*, intervistoi një numër të konsiderueshëm të të dënuarve dhe nuk pranoi asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës të ushtruar nga zyrtarët korrektues. MKPT-ja vërejti se ekziston një klimë pozitive e marrëdhënieve dhe komunikim i mirë interaktiv ndërmjet të dënuarve dhe zyrtarëve korrektues.

Kushtet materiale

4. Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale shprehimisht përcakton se i dënuari ka të drejtë në strehim, i cili u përgjigjet kushteve bashkëkohore higjenike dhe

irrethanave vendore klimatike.¹ Më tej ligji përcakton: “*Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar, duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra kub hapësirë dhe kur është e mundshme nëntë (9) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta dhe katër (4) metra katrorë pér të dënuarit në qeli të vetme, si dhe të ketë sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale pér punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.*² Për më shumë, ky ligj përcakton se lokalet nuk duhet të kenë lagështi dhe duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme pér higjenë personale.³

5. MKPT-ja vërejti se qelitë ku qëndronin të dënuarit, sa i përket madhësisë dhe ndriçimit natyral dhe artificial, në shumicën e qelive ku akomodohen të dënuarit, janë në pajtim me standardet e përcaktuar nga Komiteti pér Parandalim të Torturës⁴ (në tekstin e mëtejmë KPT) dhe nga Ligji pér Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.⁵ Përveç në një rast, ku MKPT-ja vërejti se në një qeli ishin vendosur 7 persona, ndërsa madhësia e qelisë ishte 25 m². Kjo madhësi e qelisë dhe numri i personave të vendosur nuk janë në pajtim me Ligjin pér Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Standardet e KPT-së. MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin veprime pér t'i evitar këto mangësi.
6. Sa u përket dusheve dhe tualeteve në krahët D dhe C, MKPT-ja vërejti se nuk ishin në gjendje të kënaqshme. Po ashtu, pastërtia në dushe dhe në tualetet në këtë pjesë nuk ishte në nivel të duhur. MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin veprime pér t'i evitar këto mangësi.
7. MKPT-ja, në katin e dytë të ndërtesës, vërejti se është i nevojshëm renovimi urgjent i kulmit, nga ku depërtojnë të reshurat atmosferike dhe në disa qeli vërehej depërtimi i lagështisë në tavane.

Ushqimi

8. Kurse pér personat e dënuar, Ligji pér Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton të drejtën e tyre pér ushqim të përshtatshëm, pér ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tij në tri shujta pér çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojlojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, aq sa është e mundur, kërkësave të tij fetare dhe kulturore.⁶
9. Më tej ligji përcakton se personi i dënuar, i cili kryen punë të rënda, personi i sëmurë, gruaja shtatzënë, ose ajo e cila ka lindur fëmijë, kanë të drejtë pér ushqim të caktuar nga mjeku edhe pér ushqim dietal.⁷ Mjeku, ose eksperti tjetër pér ushqim, e kontrollon

¹ Ligji nr. 04/L-149 pér Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 36, paragrafi 1.

² Ligji nr. 04/L-149 pér Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 36, paragrafi 2.

³ Ligji nr. 04/L-149 pér Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 36, paragrafi 3.

⁴ Komiteti Evropian pér Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit pér një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449>.

⁵ Ligji nr. 04/L-149 pér Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 36, paragrafi 2.

⁶ Ligji nr. 04/L-149 pér Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 39 par. 1.

⁷ Ligji nr. 04/L-149 pér Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 39, par. 2.

ushqimin dhe, para shërbimit të çdo shujte, e njofton drejtorin e institucionit korrektues për cilësinë e tij dhe konstatimet e tij i shënohen në librin përkatës.⁸

10. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti se kushtet higjenike në kuzhinë ishin në nivelin e duhur. Stafi i kuzhinës ishin të pajisur me libreza sanitare. Përveç stafit, të pajisura me libreza sanitare ishin edhe të dënuarit e angazhuar në punë. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit sa i përket sasisë dhe kualitetit të ushqimit që u shërbehet.

Regjimi

11. Sipas Drejtorisë së Qendrës Korrektuese në Smrekonicë (më tej *Drejtoria*) në përgjithësi, 75 të dënuar janë të angazhuara në punë. Momentalisht të dënuarit angazhohen në punë për pastrim, për kuzhinë dhe për mirëmbajtje të caktuara të objektit. Ndërsa gjatë stinës së verës, angazhimi në punë rritet dukshëm, pasi që QKS-ja posedon serrë ku kultivohen perimet. Përveç kësaj, brenda perimetrit të burgut ka edhe sipërfaqe me tokë bujqësore ku kultivohen kultura të ndryshme. Sipas Drejtorisë, një i burgosur është i angazhuar në punë për një kompani jashtë QKS-së dhe, pas mbarimit të orarit të punës, kthehet në QKS.
12. Në dispozicion të të burgosurve është sala e fitnesit, e pajisur mjaft mirë, biblioteka e pajisur me një numër të madh titujsh, tavolina, karrige dhe dhoma ku të burgosurit mund t'i kryejnë ritualet fetare. Përveç kësaj, dhomat e të burgosurve janë të pajisura me TV kabllor. Të burgosurit mund të lëvizin brenda perimetrit të QKS-së gjatë tërë ditës. Oborri i QKS-së ofron një pamje shumë të bukur dhe është i rregulluar shumë mirë.
13. Megjithatë, është për keqardhje që punëtoritë në dispozicion nuk mund të shfrytëzohen ende, për shkak të mungesës së personave kompetentë, të cilët do ta mbikëqyrnin punën e të dënuarve nga aspekti profesional. MKPT-ja konsideron se autoritet kompetente duhet të ndërmarrin masa për t'i funksionalizuar këto punëtori, të cilat do ta mundësonin angazhimin e të dënuarve në aktivitete të mirëfillta.

Kujdesi shëndetësor

14. Neni 43 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë për shërbime shëndetësore pa pagesë. Personi i dënuar, të cilat nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues, dërgohet në spitalin e burgut, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjeter, për përkujdesje shëndetësore.⁹

Shërbimet shëndetësore

15. Personeli mjekësor në QKS përbëhet nga: një mjek i përgjithshëm i rregullt, nga ora 08:00 deri në orën 16:00, si dhe në thirrije 24 orë. Në kuadër të shërbimit mjekësor janë katër infermierë - njëri kryeinfermier punon prej orës 08:00 deri në orën 16:00, kurse të tjerët punojnë me ndërrime. Vlen të përmendet se ndërrimet e natës jo gjithmonë mund të mbulohen nga personeli shëndetësor. Psikologu është i rregullt prej orës 08:00 deri në orën 16:00. Stomatologu është në dispozicion një herë në javë. Shërbime tjera shëndetësore specialistike janë të rregulluara ashtu që ofrohen edhe nga mjekët

⁸ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 39, par. 3.

⁹ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 43, par. 2.

konsulentë të specializimeve të ndryshme në QMF, sipas nevoje, ose në shërbime sekondare dhe terciare. Barnatorja është e furnizuar mirë me medikamente, me material shpenzues dhe me material higjenik.

Ankesat e të burgosurve lidhur me shërbimet mjekësore

16. Gjatë vizitës, MKPT-ja pranoi një numër ankesash nga të dënuarit lidhur me vonesat për t'u ofruar shërbime mjekësore, për mungesë të shërbimeve mjekësore gjatë natës nëse është e nevojshme, si dhe ankesa me pretendimin se psikiatri është shumë rrallë prezent në QKS për t'ua ofruar atyre shërbimet e nevojshme mjekësore. Pohime të tilla u pranuan edhe nga Drejtoria, e cila shprehu shqetësimin për mungesë të prezencës më të shpeshtë të psikiatrit, me arsyetimin se në QKS ka të burgosur, të cilëve u duhen shërbimet e psikiatrit. MKPT-ja, përmes këtij Raporti, kërkon nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve që t'ia dërgojë komentet lidhur me këto pohime.

Rëndësia e kontrolleve mjekësore për të burgosurit e apo pranuar

17. KPT-ja vazhdimisht thekson rëndësinë e ekzaminimit mjekësor të të burgosurve të apo pranuar, veçanërisht në institucionet të cilat përbëjnë pikë hyrje në sistemin e burgjeve. Një ekzaminim i tillë është esencial, veçanërisht për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe përhapjen e sëmundjeve transmetuese (siç janë tuberkulozi, hepatiti B/C, HIV).
18. Sipas KPT-së, shërbimet mjekësore të burgut po ashtu mund të japid kontribut të rëndësishëm në parandalimin e keqtrajtimit fizik, gjatë periudhës menjëherë para burgosjes, domethënë, në periudhën kur personat janë në mbajtje nga agjencitë e zbatimit të ligjit, përmes regjistrimit sistematik dhe me kohë të lëndimeve dhe kur kjo është e përshtatshme, përmes sigurimit të informatave për autoritetet relevante.¹⁰
19. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale¹¹ dhe Praktika Standarde e Veprimeve¹² e DShB-së përcaktojnë obligimin që i burgosuri i apo pranuar t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.
20. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve siç janë: Rregullat e Mandelës¹³, Rregullat Evropiane të Burgjeve¹⁴ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.¹⁵
21. Qendra korrektuese e njoftoi ekipin e MKPT-së se të apo pranuarit kontrollohen brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i arritjes në QKS. Këto nënkuuptojnë një kontroll të

¹⁰ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 26-të i Përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8>.

¹¹ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 31.

¹² Praktika Standarde e Veprimeve, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

¹³ Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf.

¹⁴ Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

¹⁵ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika 27, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf.

përgjithshëm, sipas Praktikave Standarde të Veprimit (PSV) të DShB-së. Ky pohim u vërtetua nga ekipi monitorues përmes kontrollit të dosjeve mjekësore dhe përmes intervistave me të burgosurit.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

22. Sa i përket konfidentialitetit të shërbimeve mjekësore, MKPT-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe me personelin shëndetësor, konstaton se këto shërbime jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidentialitetin, respektivisht jepen pa prezencë të zyrtarëve korrektues, përveç në raste kur prezenca e tyre kërkohet nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor. Konfidentialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me Praktikën Standarde të Veprimit,¹⁶ e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale¹⁷, me standardet e KPT,¹⁸ si dhe me aktet ndërkombëtare, siç janë: Rregullat e Mandelës¹⁹ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.²⁰

Masat disiplinore

23. Sipas legjislacionit në fuqi, dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: Qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vëtmia.²¹ Kurse në rastin e të paraburgosurve, mund të shqiptohen dënimet si në vijim: Kufizimi apo ndalimi i vizitave apo i korrespodencës, përveç kontaktave me avokatin mbrojtës, me Avokatin e Popullit dhe me misionet diplomatike. Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftu nga Drejtoria se në QKS nuk aplikohet masa disiplinore e vëtmisë.

Kontakti me botën e jashtme

24. MKPT-ja konsideron se kontaktet me botën e jashtme, veçanërisht vizitat nga familja apo nga të afërmët tjerë, janë të rëndësishë thelbësore në kontekstin e rehabilitimit social të të burgosurve.

25. Legjislacioni në fuqi,²² për rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespodencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe kanë të drejtë për një vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Sipas Drejtorisë së QKS-së, të burgosurit kanë të drejtë të kenë deri në katër vizita në muaj.

26. Sa u përket thirrjeve telefonike, nen 60 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike. Për t'i lehtësuar kontaktet me

¹⁶ Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

¹⁷ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 49.

¹⁸ Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafët 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

¹⁹ Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf.

²⁰ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf.

²¹ Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

²² Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

familjen, Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK), në vitin 2018, ka përgatitur Praktikën Standarde të Veprimit për komunikim virtual në institucionet korrektuese. Bazuar në këtë dokument, do të tentohet që në QKS dhe në Qendrën Edukativo-Korrektuese në Lipjan, të burgosurve të kategorive të caktuara, t'u mundësohet komunikimi virtual përmes aplikacionit SKYPE. MKPT-ja mirëpret këtë zhvillim, po ashtu kërkon nga ShKK-ja që ta njoftojë për risitë lidhur me implementimin e këtij programi komunikimi.

27. MKPT-ja vizitoi edhe sallën e vizitave familjare, e cila ofron kushte të kënaqshme për të pranuar vizita familjare, si dhe ofron mundësinë që i burgosuri të ketë kontakt të drejtpërdrejtë (nuk ka bariera ndërmjet tyre) me familjarin apo personin nga i cili vizitohet.

Procedurat e pranimit

28. Të gjithë të apo pranuarit në QKS i nënshtronen procedurës së pranimit, e cila zgjat nga 7, e më së shumti deri në 28 ditë. Gjatë kësaj periudhe, i dënuari mbahet në pavillonin e pranimit dhe, pas kësaj periudhe, dërgohet në pavillonin adekuat, varësisht nga dënim i shqiptuar apo masa edukative korrektuese. MKPT-ja vërejti se QKS mban evidencë gjithëpërfshirëse për secilin të burgosur, ku regjistrohet në hollësi çdo detaj për të burgosurin.

Procedura e parashtrimit të ankesave

29. Standardet e KPT-së theksojnë rëndësinë e sistemit efektiv të parashtrimit të ankesave dhe e konsiderojnë atë si garanci themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit.
30. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që anesa t'i drejtohet një autoriteti tjeter, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe ministri i Drejtësisë.²³
31. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve në QKS gjenden kutitë e ankesave, të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe ato të DShB-së. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.
32. Po ashtu, ata mund t'i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit edhe përmes linjës telefonike pa pagesë (informatat për linjën telefonike janë të vendosura në kutitë e ankesave), për postës së irregullt, e cila, sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nuk i

²³ Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: Në ankimin e paraqitur, drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën e shkruar.

nënshtrohet kontrollit nëse i adresohet Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, si dhe përmes familjarëve të tyre.

33. MKPT-ja vërejti se Drejtoria e QKS-së ofron mundësinë adekuate për parashtrim të ankesave dhe të kërkesave, i shqyrton ato dhe u dërgon përgjigje të burgosurve në këtë qendër, në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit, sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë.

Ankesat kundër Panelit për Lirim me Kusht

34. MKPT-ja mori një numër të konsiderueshëm të ankesave nga të dënuarit në QKS, të parashtruara kundër Panelit për Lirim me Kusht. Ankesat kanë të bëjnë me mosnjoftimin për mbajtje të seancës në Panel dhe mosdërgimin e aktvendimit lidhur me kërkesën për lirim me kusht. Përveç në QKS, MKPT-ja mori ankesa të tilla në të gjitha qendrat tjera korrektuese. MKPT-ja, përmes këtij Raporti, kërkon nga Paneli për Lirim me Kusht t’ia dërgojë komentet lidhur me këto ankesa të të burgosurve.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon:

Ministrisë së Drejtësisë:

- **Të rinovohet kulmi i pavijonit ku akomodohen të dënuarit.**
- **Të funksionalizohen punëtoritë në QKS.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkua të pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësish që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.



Me nderime,
Hilmij Jashari

Avokat i Popullit